



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 133

Tiranë – E premte, 27 gusht 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 13204, datë 26.8.2021	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 13623
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 501, datë 25.8.2021	Për dhënien e mbrojtjes së përkohshme shtetasve afganë dhe personave pa shtetësi, me vendqëndrim të përkohshëm ose të përhershëm në Republikën Islamike të Afganistanit, dhe për krijimin e task-forcës për menaxhimin e fluksit të kërkuësve të mbrojtjes ndërkombëtare..... 13623
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 503, datë 25.8.2021	Për rishpërndarje fondesh në buxhetin e vitit 2021, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes..... 13624
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 504, datë 25.8.2021	Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rigjenerim urban i shëtitorës bregdetare qendrore të Vlorës, sheshit ‘Isa Boletini’ dhe Portit, Bashkia Vlorë”..... 13624
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 349/1, datë 6.8.2021	Për një ndryshim në urdhrin nr. 633, datë 17.11.2020, “Për ndalimin e grumbullimeve në vende të mbyllura apo të hapura”, të ndryshuar 13627
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 41, datë 4.8.2021	Për një ndryshim në rregulloren “Për mbikëqyrjen e konsoliduar”..... 13627
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 42, datë 4.8.2021	Për miratimin e rregullores “Për medaljet dhe xhetonat të ngjashëm me monedhën metalike euro”..... 13627
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 43, datë 4.8.2021	Për miratimin e rregullores “Për kriteret për riprodhimin e kartëmonedhave dhe/ose monedhave metalike në Republikën e Shqipërisë”..... 13632

**DEKRET**

Nr. 13204, datë 26.8.2021

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe të nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 9, 20 e në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozimin e ministrit të Brendshëm

DEKRETOJ:**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, këtyre personave:

1. Islam Leçi (Lechi) Dudaev
2. Zelimhan (Zelimkhan) Arsen Abakarov

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**
Ilir Meta

VENDIM

Nr. 501, datë 25.8.2021

**PËR DHËNIEN E MBROJTJES SË
PËRKOHSHME SHTETASVE AFGANË
DHE PERSONAVE PA SHTETËSI, ME
VENDQËNDRIM TË PËRKOHSHËM
OSE TË PËRHERSHËM NË
REPUBLIKËN ISLAMIKE TË
AFGANISTANIT, DHE PËR KRIJIMIN E
TASK-FORCËS PËR MENAXHIMIN E
FLUKSIT TË KËRKUESVE TË
MBROJTJES NDËRKOMBËTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 82, të ligjit nr. 10/2021, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Brendshëm dhe të ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e mbrojtjes së përkohshme shtetasve me shtetësi apo kombësi afgane dhe personave pa shtetësi, me vendqëndrim të përkohshëm ose të përhershëm në Republikën Islamike të Afganistanit, që hyjnë masivisht dhe të koordinuar me partnerët ndërkombëtarë në territorin e Republikës së Shqipërisë, për arsye të luftës, situatës së ngjashme, dhunës së përgjithshme dhe konfliktit të brendshëm, të karakterizuara nga shkelje të të drejtave të njeriut dhe që kërkojnë mbrojtje nga Republika e Shqipërisë.

2. Mbrojtja e përkohshme për këta shtetas fillon nga momenti i hyrjes në Republikën e Shqipërisë për një afat 1-vjeçar.

3. Përfshihen nga e drejta e mbrojtjes së përkohshme të gjithë personat të cilët plotësojnë një nga kushtet e përcaktuara në nenin 83, të ligjit nr. 10/2021, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”.

4. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët mund të vendosë që kërkuessit t’i kufizohet liria e lëvizjes, nëse e konsideron të nevojshme, bazuar në vlerësimin individual të secilit rast, sipas përcaktimeve të neneve 46 dhe 47, të ligjit nr. 10/2021, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”.

5. Krijimin e Task-Forcës, si një strukturë e posaçme e përkohshme, për menaxhimin e fluksit të kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare nga shtetasit afganë dhe personat pa shtetësi, me vendqëndrim të përkohshëm ose të përhershëm në Republikën Islamike të Afganistanit.

6. Task-Forca kryesohet nga ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe ka në përbërje, si më poshtë vijon:

- a) ministrin e Brendshëm;
- b) ministrin e Mbrojtjes;
- c) ministrin e Financave dhe Ekonomisë;
- ç) ministrin e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
- d) ministrin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- dh) ministrin e Turizmit dhe Mjedisit.

Sipas nevojave ftohen të marrin pjesë përfaqësues të institucioneve të tjera me kërkesë të kryetarit të Task-Forcës.

7. Task-Forca ka këto detyra:

- a) negocion me partnerët ndërkombëtarë për çështjet që lidhen me objektin e këtij vendimi;



b) harton planin e veprimit për menaxhimin e fluksit të kërkuarve të mbrojtjes ndërkombëtare;

c) koordinon situatën e pritjes dhe të akomodimit të shtetasve afganë dhe personave pa shtetësi, me vendqëndrim të përkohshëm ose të përhershëm në Republikën Islamike të Afganistanit;

ç) evidenton nevojat emergjente për t'i paraprirë punës me ndryshimet e mundshme të kuadrit ligjor, nënligjor e rregullator, të cilat ndikojnë në përmirësimin në këtë funksion;

d) analizon kërkesat shtesë buxhetore për funksionimin, shpenzimet dhe bazën e nevojshme materiale, si dhe koordinon fondet e donatorëve për këtë qëllim.

8. Task-Forca ndihmohet nga sekretariati teknik në detyrat administrative. Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe ministri i Brendshëm janë përgjegjës për ngritjen e këtij sekretariati, përcaktimin e përbërjes dhe të mënyrës së funksionimit të tij.

9. Periudha e veprimit të Task-Forcës është deri në përfundimin e shqyrtimit të kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare nga shtetasit afganë dhe personat pa shtetësi, me vendqëndrim të përkohshëm ose të përhershëm në Republikën Islamike të Afganistanit.

10. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 503, datë 25.8.2021

PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2021, MIRATUAR PËR MINISTRINË E MBROJTJES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të shkronjës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit

nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2021, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes, të bëhet rishpërndarje e fondeve ndërmjet programeve buxhetore, si më poshtë vijon:

a) në programin buxhetor “Emergjencat civile” 10910 të shtohet fondi prej 33 000 000 (tridhjetë e tre milionë) lekësh në shpenzimet korente;

b) në programin “Forcat e luftimit” 02120 të pakësohet fondi prej 33 000 000 (tridhjetë e tre milionë) lekësh në shpenzimet korente.

2. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 504, datë 25.8.2021

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “RIGJENERIM URBAN I SHËTITORES BREGDETARE QENDRORE TË VLORËS, SHESHIT ‘ISA BOLETINI’ DHE PORTIT, BASHKIA VLORË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi projektit “Rigjenerim urban i shëtitores bregdetare qendrore të Vlorës, sheshit ‘Isa Boletini’ dhe Portit, Bashkia Vlorë”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Vlorë.

3. Pronarët të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall” dhe “ndërtesë”, me një vlerë të përgjithshme prej 70 237 995.34 (shtatëdhjetë milionë e dyqind e tridhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë pikë tridhjetë e katër) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 70 237 995.34 (shtatëdhjetë milionë e dyqind e tridhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë pikë tridhjetë e katër) lekësh, të përballohet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, nga të cilat 43 400 000 (dyzet e tre milionë e katërqind mijë) lekë të përballohen nga buxheti i vitit 2021, në programin buxhetor “Planifikimi urban”, dhe 26 837 995.34 (njëzet e gjashtë milionë e tetëqind e tridhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë pikë tridhjetë e katër) lekë të përballohen nga buxheti i vitit 2022.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2021 i Bashkisë Vlorë.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë brenda 3 (tri) muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin për likuidim, certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë, si dhe hartën treguese të regjistrimit pranë Bashkisë Vlorë.

8. Bashkia Vlorë të kryejë procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Vlorë, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuar në favor të Bashkisë Vlorë.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë në favor të Bashkisë Vlorë.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Vlorë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILAT PREKEN NGA REALIZIMI PROJEKTTI “RIGJENERIM URBAN I SHËTTTORES BREGDETARE QENDRORE TË VLORËS, SHESHIT ‘ISA BOLETINI’ DHE PORTIT, BASHKIA VLORË”

Nr.	ZK	Nr. i pasurisë	Adresa	Pronari	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja e pronës “truall”	Sipërfaqja e pronës “ndërtesë”	Sip. e truallit që preket nga projekti	Çmimi i truallit lekë/m²	Vlera e truallit lekë	Sipërfaqja e ndërtimit	Vlera e ndërtimit me situacion lekë	Vlera e truallit dhe ndërtesës	Shënime
1	8602	33/22	Vlorë	Loni Llambro	Truall	750		273	10,903	2,976,519		-	2,976,519	Mungon dosja e origjinës.
2	8602	33/23	Vlorë	Safet Abazi	Truall	800		20	10,903	218,060		-	218,060	
3	8602	28/147	Vlorë	Augusto Agolli	Truall	49		49	10,903	534,247		-	534,247	
4	8602	28/153	Vlorë	Bp. Inataj, Karagiannidis, vino, Murrizi	Truall	190		190	10,903	2,071,570		-	2,071,570	
5	8602	28/121	Vlorë	Flavio Bejleri, Ardian Dauti	Truall	2015.2		2015.2	10,903	21,971,726		-	21,971,725.60	
6	8602	28/120	Vlorë	Flavio Bejleri, Ardian Dauti	Truall	439.18		439.18	10,903	4,788,380		-	4,788,379.54	
7	8602	28/92	Vlorë	Rudina Hitaj	Truall	200	200	200	10,903	2,180,600	200	3,950,786	6,131,386	Ka 2 hipotekime banke. Vlera e ndërtesës është llogaritur me situacion punimesh.
8	8602	28/95-T	Vlorë	Shpresa Taushani	Truall	460		460	10,903	5,015,380		-	5,015,380	RVP.
9	8602	29/85-Nd. 1	Vlorë	Shpresa Taushani	Ndërtesë		235				235	8,787,943	8,787,943	RVP. Vlera e ndërtesës është llogaritur me situacion punimesh.
10	8602	28/95-Nd. 2	Vlorë	Shpresa Taushani	Ndërtesë		16				16			Të dy pronat, 29/85-ND. 1 dhe 28/95-ND. 2, janë llogaritur në një situacion të vetëm.
11	8602	28/48/5	Vlorë	Edmond Rexho	Truall	498	67	498	10,903	5,429,694	67	2,954,938	8,384,632	Vlera e ndërtesës është llogaritur me situacion punimesh.
12	8602	28/111	Vlorë	BP Çela, Mehmeti	truall	346	98.6	346	10,903	3,772,438	98.6	2,310,454	6,082,892	Vlera e ndërtesës është llogaritur me situacion punimesh.
13	8602	27/46	Vlorë	Liri Gjiku	Truall	335		127.7	10,903	1,392,313		-	1,392,313.10	
14	8602	27/41	Vlorë	BP Hondro	Truall	300		78.2	10,903	852,615		-	852,614.60	
15	8602	28/34-T	Vlorë	Aldo, Fatmira Serjani	Truall	900		94.5	10,903	1,030,334		-	1,030,333.50	
VLERA TOTALE								4,791	10,903	52,233,874.34	617	18,004,121.00	70,237,995.34	

Shënime:

1. Për vlerësimin e pasurive të llojit “tokë truall”, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja nr. 89, datë 3.2.2016, ku për ZK 8603 është 10,903 lekë/m².

2. Për vlerësimin e pasurive të llojit “ndërtesë”, çmimi/m² është bërë sipas VKM-së nr. 138, datë 23.3.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërbërimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar.



URDHËR
Nr. 349/1, datë 6.8.2021

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN
NR. 633, DATË 17.11.2020, “PËR
NDALIMIN E GRUMBULLIMEVE NË
VENDE TË MBYLLURA APO TË
HAPURA”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 4, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19, si edhe në zbatim të vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirusi i ri nr. 3221 prot., datë 19.7.2021,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 633, datë 17.11.2020, “Për ndalimin e grumbullimeve në vende të mbyllura apo të hapura”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi si vijon:

1. Në pikën 1 të urdhrit. togfjalëshi “deri në datën 9.8.2021”, zëvendësohet me togfjalëshin “sderi në datën 23.8.2021”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE**
Ogerta Manastirliu

VENDIM
Nr. 41, datë 4.8.2021

**PËR NJË NDRYSHIM NË
RREGULLOREN “PËR MBIKËQYRJEN
E KONSOLIDUAR”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a”, dhe të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe të nënkreut II, të kreut VI, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me

propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin e datës së hyrjes në fuqi të shkronjës “a”, të pikës 1, të vendimit nr. 54, datë 2.9.2020, “Për disa ndryshime në rregulloren “Për mbikëqyrjen e konsoliduar”, nga data 1 qershor 2021, në datën 1 janar 2022.

2. Ngarkohen bankat e licencuara nga Banka e Shqipërisë me zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Statistikave Financiare për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko

VENDIM
Nr. 42, datë 4.8.2021

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR MEDALJET DHE XHETONAT TË
NGJASHËM ME MONEDHËN
METALIKE EURO”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a”, nenit 43, shkronja “c”, dhe kreut V, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozimin e Departamentit të Emisionit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Për medaljet dhe xhetonat të ngjashëm me monedhën metalike euro”, sipas tekstut bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Departamenti i Emisionit në Bankën e Shqipërisë dhe subjektet që prodhojnë, importojnë, shesin dhe/ose shpërndajnë medalje dhe xhetona në Republikën e Shqipërisë, me zbatimin e kësaj rregulloreje.



3. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

4. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETAR
Gent Sejko

RREGULLORE
PËR MEDALJET DHE XHETONAT TË
NGJASHËM ME MONEDHËN METALIKE
EURO

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kriterëve teknike të lejueshme për prodhimin, importimin, shitjen, dhe/ose shpërndarjen e medaljeve dhe xhetonave të ngjashëm me monedhën metalike euro.

Neni 2
Baza juridike

Kjo rregullore nxirret duke u mbështetur në sa vijon:

a) nenit 12, shkronja “a”, nenit 43, shkronja “c”, dhe kreut V, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

b) nenit 70 pika 1, dhe nenit 85, të ligjit nr. 9590, datë 27.7.2006, “Për ratifikimin e ‘Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e Shteteve të tyre Anëtare”.

Neni 3
Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat, degët e bankave të huaja dhe subjektet financiare jobanka, të licencuara për të ushtruar veprimtari bankare dhe/ose financiare në Republikën e

Shqipërisë, si dhe operatorët ekonomikë të përfshirë në prodhimin, importimin, shitjen, dhe/ose shpërndarjen për qëllime të ndryshme tregtare, të medaljeve dhe xhetonave.

Neni 4
Përkufizimet

1. Për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm do të kenë këto kuptime:

a) “Euro” – është monedha metalike me kurs ligjor në vendet anëtare të Eurosistemit dhe shteteve që kanë arritur një marrëveshje me Komunitetin Evropian për përdorimin e monedhës euro;

b) “Simboli euro” – është simboli që përfaqëson euron “€”, siç tregohet dhe përshkruhet në aneksin e bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje;

c) “Medaljet dhe xhetonat” – janë ato objekte metalike, përveç pullave metalike të fabrikua dhe të destinuara për emetimin e monedhave metalike me kurs ligjor, që kanë pamjen dhe/ose vetitë teknike të një monedhe metalike, por që nuk janë me kurs ligjor ose nuk shërbejnë si mjet pagese;

d) “Ar, argjend dhe platin” – janë aliazhet që përmbajnë ar, argjend dhe platin me një pastërti në peshë prej së paku përkatësisht 375, 500 dhe 850 të mijtat;

e) “Brezi i referencës” – do të ketë kuptimin sipas përcaktimeve në pikën 1, të aneksit II, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje;

f) “Operatorët ekonomikë” – janë personat fizikë ose juridikë të përfshirë në prodhimin, importimin, shitjen dhe/ose shpërndarjen për qëllime të ndryshme tregtare, të medaljeve dhe xhetonave.

KREU II
KËRKESAT PËR MEDALJET DHE
XHETONAT

Neni 5
Kritere teknike ndaluese

1. Prodhimi, importimi, shitja, dhe/ose shpërndarja e medaljeve ose xhetonave të ngjashëm me monedhën metalike euro ndalohet, në rastin



kur plotësohen një ose më shumë nga kriteret e mëposhtme:

a) në sipërfaqen e tyre mbajnë termat “euro”, “cent euro” ose simbolin e euros;

b) përmasat e tyre janë brenda brezit të referencës; ose

c) dizajni në sipërfaqen e tyre ka pamje të ngjashme me:

i. çdo pamje të dizajnit apo pjesë e tij që shfaqen në monedhat metalike euro, veçanërisht termat “euro” ose “cent euro”, 12 yjet e Bashkimit Evropian, imazhin gjeografik dhe numrat, ashtu siç paraqiten në monedhat metalike euro; ose

ii. simbolet përfaqësuese të sovranitetit kombëtar të shteteve anëtare, ashtu siç paraqiten në monedhat euro, duke përfshirë në veçanti portretet e kreut të shtetit, simbolin e shtetit, shenjat e prodhuesit, emrin e shtetit anëtar;

iii. formën ose dizajnin e buzëve anësore të monedhave metalike euro;

iv. simbolin e euros.

2. Banka e Shqipërisë, bashkëpunon me Qendrën Tekniko-Shkencore Evropiane (ETSC) pranë Komisionit Evropian, si autoriteti kompetent për këtë qëllim, për përcaktimin e medaljeve dhe xhetonave të ngjashëm me monedhën metalike euro.

3. Banka e Shqipërisë, në përputhje me pikën 1 të këtij neni, dërgon te ETSC-ja, të gjitha objektet metalike që i bien në zotërim, kur konstaton paraprakisht, se këto objekte ngjasojnë dhe mund të ngatërrohen me monedhat metalike euro. ETSC-ja bën përcaktimin përfundimtar nëse këto objekte metalike janë medalje ose xhetona të ngjashëm me euron.

Neni 6 Përjashtimet

1. Medaljet dhe xhetonat që mbajnë vetëm termat “euro”, “cent euro” ose “simbolin e euros” nuk ndalohen në rastin kur plotësohen kriteret e mëposhtme:

a) janë pa vlerën nominale;

b) përmasat e tyre janë jashtë brezit të referencës, të përcaktuar në pikën 1, të aneksit II, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje; dhe

c) dizajni i tyre nuk shfaq pamje sipas përcaktimeve të shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 5, të kësaj rregulloreje.

2. Medaljet dhe xhetonat, kur përmasat e tyre janë brenda brezit të referencës, nuk ndalohen në rastet kur plotësohet një nga kushtet e mëposhtme:

a) janë të shpuara në qendër me një vrimë me diametër më të madh se 6 milimetra, ose kur forma e tyre është poligonale, por jo më tepër se gjashtëkëndore dhe kur plotësohen përcaktimet e germës “c/ ii” të kësaj pike; ose

b) janë prej ari, argjendi ose platini; ose

c) kur plotësojnë kushtet e mëposhtme:

i. kombinimet e diametrit dhe lartësisë së buzës së medaljeve dhe xhetonave janë gjithmonë jashtë kufijve të përcaktuar në secilin prej rasteve të specifikuar, në pikën 2 të aneksit II, bashkëngjitur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje;

ii. kombinimet e diametrit dhe cilësitë e metalit të medaljeve dhe xhetonave janë gjithmonë jashtë kufijve në secilin prej rasteve të specifikuar në pikën 3, të aneksit II, bashkëngjitur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

KREU III TË TJERA

Neni 7

Raportimi mbi medaljet dhe xhetonat ekzistues

1. Medaljet dhe xhetonat e importuar ose prodhuar para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, që nuk janë në përputhje me kriteret teknike të përcaktuar në këtë rregullore, mund të vazhdojnë të përdoren deri në fund të vitit 2022.

2. Subjektet që përdorin medalje dhe xhetona të importuar ose prodhuar para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, paraqesin çdo vit në Bankës së Shqipërisë raportin që përmban:

a) emrin e prodhuesit të medaljeve dhe/ose xhetonave;

b) numrin e medaljeve dhe ose xhetonave të shpërndarë;

c) specifikimet e plota teknike të shoqëruara me pamjet e të dy faqeve të medaljes ose xhetonit;

d) vendet e përdorimit të tyre.

3. Në raportin e parë të përcaktuar në pikën 2 më lart, përfshihet dhe një specimen i xhetonave dhe/ose medaljeve.



4. Raporti i parë, që i takon vitit 2021, duhet raportuar jo më vonë se data 31 janar 2022 dhe raporti i fundit për vitin 2022 jo më vonë se data 31 janar 2023.

Neni 8

Zbatimi i kërkesave rregullative dhe masat për ndërprerjen e shkeljeve

1. Në rastet kur Banka e Shqipërisë konstaton ose vihet në dijeni/informohet për mosrespektim të kërkesave të kësaj rregulloreje, kërkon nga ana e subjekteve dërgimin e mostrave përkatëse të xhetonit ose monedhës me qëllim përcaktimin nëse janë të ngjashme dhe mund të ngatërrohen nga publiku si monedha metalike euro.

2. Banka e Shqipërisë, për objektet metalike për të cilat vlerëson se janë të ngjashëm me monedhat

metalike euro, kërkon ndërprerjen e prodhimit, importimit, shitjes dhe shpërndarjes së tyre nga ana e subjekteve.

3. Në rast moszbatimi të masave të kërkuara sipas pikave 1 dhe 2, të këtij neni nga subjektet e kësaj rregulloreje, Banka e Shqipërisë referon rastin pranë organeve përkatëse ligjzbatuese.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore do të hyjë në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETAR I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Gent Sejko

ANEKS I

Pamje e simbolit EURO





ANEKS II

1. Përkufizimi i brezit të referencës

a) Brezi i referencës për madhësinë e medaljeve dhe xhetonave është grupi i kombinimeve të vlerave të diametrit dhe të lartësisë së buzës që përfshihen përkatësisht në referencën e kufirit për diametër dhe referencën e kufirit për lartësinë e buzës.

b) Referenca e kufijve të diametrit përcaktohet midis 19,00 milimetra dhe 28,00 milimetra.


c) Referenca e kufirit për lartësinë e buzës përcaktohet midis 7,00% dhe 12,00% të secilës vlerë brenda referencës së kufijve të diametrit.

2. Kombinimet e diametrit dhe lartësisë së buzës së medaljeve dhe xhetonave

Kufijtë e përcaktuar		
	Diametri mm	Lartësia e buzës
1	19,45-20,05	1,63-2,23
2	21,95-22,55	1,84-2,44
3	22,95-23,55	2,03-2,63
4	23,95-24,55	2,08-2,68
5	25,45-26,05	1,90-2,50

3. Kombinimet e diametrit dhe cilësitë e metalit të medaljeve dhe xhetonave

	Diametri	Cilësitë metalike
1	19,00-21,94	Përçueshmëria elektrike midis 14,00% dhe 18,00% IACS
2	21,95-24,55	Përçueshmëria elektrike midis: - 14,00% dhe 18,00% IACS; ose - 4,50% dhe 6,50% IACS, përveç rastit kur medalja ose xhetoni është një aliazh i vetëm dhe momenti magnetik është jashtë intervalit nga 1,0 μ Vs.cm në 7,0 μ Vs.cm
3	24,56-26,05	Përçueshmëria elektrike midis: - 15,00% dhe 18,00% IACS ; ose - 13,00% dhe 15,00% IACS, përveç rastit kur medalja ose xhetoni është një aliazh i vetëm dhe momenti magnetik është jashtë intervalit nga 1,0 μ Vs.cm në 7,0 μ Vs.cm
4	26,06-28,00	Përçueshmëria elektrike midis 13,00% dhe 15,00% IACS, përveç rastit kur medalja ose xhetoni është një aliazh i vetëm dhe momenti magnetik është jashtë intervalit nga 1,0 μ Vs.cm në 7,0 μ Vs.cm

4. Grafik për ilustrimin e treguesve sipas përkufizimeve në aneksin II



VENDIM
Nr. 43, datë 4.8.2021

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR KRITERET PËR RIPRODHIMIN E
KARTËMONEDHAVE DHE/OSE
MONEDHAVE METALIKE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a”, nenit 43, shkronja “c”, dhe kreut V, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozimin e Departamentit të Emisionit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Për kriteret për riprodhimin e kartëmonedhave dhe/ose monedhave metalike në Republikën e Shqipërisë”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Departamenti i Emisionit në Bankën e Shqipërisë dhe subjektet e përfshira në riprodhimin e kartëmonedhave dhe/ose monedhave në Republikën e Shqipërisë, me zbatimin e kësaj rregulloreje.

3. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi në Buletin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

4. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETAR
Gent Sejko

RREGULLORE
PËR KRITERET PËR RIPRODHIMIN E
KARTËMONEDHAVE DHE/OSE
MONEDHAVE METALIKE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kriterëve teknike të lejueshme për riprodhimin e

imazhit të kartëmonedhave dhe/ose monedhave metalike në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2
Baza juridike

Kjo rregullore nxirret duke u mbështetur në sa vijon:

a) nenin 12, shkronja “a”, nenin 43, shkronja “c”, dhe kreun V, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

b) nenin 70, pika 1 dhe nenin 85, të ligjit nr. 9590, datë 27.7.2006, “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e Shteteve të tyre Anëtare”.

Neni 3
Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat, degët e bankave të huaja dhe subjektet financiare jobanka, të licencuara për të ushtruar veprimtari bankare dhe/ose financiare në Republikën e Shqipërisë, si dhe operatorët ekonomikë të përfshirë në riprodhimin e kartëmonedhave dhe / ose monedhave metalike.

Neni 4
Përkufizimet

1. Për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm do të kenë këto kuptime:

a) “Riprodhim” – është çdo imazh i prekshëm ose elektronik që shfaq pamjen e plotë ose të pjesshme të një kartëmonedhe/monedhe metalike ose pjesë të elementeve individuale të dizenjës së saj, të tilla si: ngjyrat, dimensionet, përdorimin e shkronjave dhe simboleve, pamja e të cilave mund të ngjajë ose të japë përshtypjen e përgjithshme të një kartëmonedhe/monedhe metalike të vërtetë, pavarësisht:

- i. përmasave të imazhit; ose
- ii. materialeve dhe teknikave të përdorura në riprodhimin e saj; ose
- iii. nëse janë ose nuk janë ndryshuar ose shtuar elemente të dizenjës së kartëmonedhave / monedhave metalike si shkronjat apo simbolet;



b) “Kartëmonedha” – janë kartëmonedhat lek ose euro me kurs ligjor, si dhe ato pa kurs ligjor që këmbehen kundrejt vlerës fillestare të emetimit;

c) “Monedhë metalike” – janë monedhat metalike lek me kurs ligjor dhe ato që këmbehen kundrejt vlerës fillestare të emetimit;

d) “Operatorët ekonomikë” – janë personat fizikë ose juridikë të përfshirë në prodhimin, përdorimin dhe shpërndarjen për qëllime të ndryshme tregtare të riprodhimeve sipas shkronjës “a”, të kësaj pike.

Neni 5

Kritere për riprodhimin e kartëmonedhave

1. Riprodhimet, të cilat mund të ngatërrohen nga publikun i gjerë si kartëmonedha të vërteta nuk lejohen. Prodhimi, posedimi, transportimi, shpërndarja, shitja, promovimi, përdorimi i tyre apo përpjekja për t'u përdorur në transaksione është e ndaluar.

2. Riprodhimet do të klasifikohen si jo të ngatërrueshëm nga publiku i gjerë për kartëmonedha të vërteta, në rastin kur plotësojnë të paktën njërin prej kriterëve të mëposhtme:

a) janë riprodhime të vetëm një faqeje të një kartëmonedhe, me kusht që përmasat e riprodhimit të jenë të barabarta ose më të madha se 125% e gjatësisë dhe gjerësisë njëkohësisht ose të barabarta apo më të vogla se 75% e gjatësisë dhe gjerësisë njëkohësisht të kartëmonedhës përkatëse; ose

b) janë riprodhime të të dyja faqeve të një kartëmonedhe, me kusht që përmasat e riprodhimit të jenë të barabarta ose më të madha se 200% e gjatësisë dhe gjerësisë njëkohësisht ose të barabarta ose më të vogla se 50% e gjatësisë dhe gjerësisë njëkohësisht të kartëmonedhës përkatëse; ose

c) janë riprodhime të çdo elementi të veçantë të dizajnit të një kartëmonedhe, me kusht që një element i tillë dizajni nuk është shfaqur mbi një sfond që i ngjan një kartëmonedhe; ose

d) janë riprodhime vetëm në një faqe dhe shfaqin pamjen e pjesshme të faqes së përparme ose të pasme të një kartëmonedhe, me kusht që kjo pjesë të jetë më e vogël se një e treta e kartëmonedhës origjinale; ose

e) janë riprodhime të bëra prej një materiali qartësisht të ndryshëm nga letra ose polimeri, i cili duket qartësisht i ndryshëm nga materiali i përdorur për kartëmonedhat origjinale; ose

f) janë riprodhime elektronike të vendosura në faqe interneti (WEB) që mund të aksesohen nga publiku, me kusht që:

i. fjala “SPECIMEN” të jetë vendosur diagonalisht përgjatë riprodhimit në shkrimin *Arial* ose një shkrim tjetër i ngjashëm me *Arial*;

ii. rezolucioni i riprodhimit elektronik në përmasat 100% të mos i kalojë 72 dpi;

iii. gjatësia e fjalës SPECIMEN duhet të jetë të paktën sa 75% e gjatësisë së riprodhimit;

iv. lartësia e fjalës SPECIMEN duhet të jetë të paktën sa 15% e gjerësisë së riprodhimit; dhe

v. fjala SPECIMEN duhet të shfaqet në një ngjyrë jotransparente dhe në kontrast me ngjyrën dominante të kartëmonedhës përkatëse.

Neni 6

Kritere për riprodhimin e monedhave metalike

1. Ndalohen riprodhimet cilat mund të ngatërrohen nga publiku i gjerë për monedha metalike të vërteta. Veçanërisht ndalohen riprodhimet që konsistojnë në vendosjen e imazhit të monedhës metalike në një disk prej metali, prej të cilit janë shtypur monedhat e vërteta ose prej një metali me ngjyrë të ngjashme, veti të ngjashme elektromagnetike dhe parametra teknike, si masa dhe dimensionet e njëjta ose të ngjashme me parametrat e monedhës së vërtetë.

2. Riprodhimet do të konsiderohen se nuk ngatërrohen nga publiku i gjerë si monedha metalike të vërteta, në rastin kur plotësojnë kriteret e mëposhtme:

a) janë 25% më të mëdha ose më të vogla se përmasat e monedhës së vërtetë; dhe

b) janë të prodhuara në materiale qartësisht të ndryshme nga metali, të tillë si: letra, druri ose plastika etj.

Neni 7

Raste të veçanta

1. Në rastet e riprodhimit të kartëmonedhave / monedhave metalike lek që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenet 5 ose 6 të kësaj rregulloreje, Banka e Shqipërisë mund të japë autorizimin për përdorimin e këtyre riprodhimeve kur ajo krijon bindjen se nuk ka rrezik që këto riprodhime mund



të ngatërrohen nga publiku i gjerë me kartëmonedhat/monedhat metalike të vërteta.

2. Për marrjen e autorizimit subjekti paraqet një kërkesë pranë Bankës së Shqipërisë. Kërkesa duhet të përmbajë:

- a) emrin e personit fizik ose personit juridik;
- b) NIPT-in e subjektit;
- c) llojin e aktivitetit;
- d) llojin dhe karakteristikat e materialit të përdorur;
- e) arsyet për realizimin e riprodhimit;
- f) të shoqërohet me një ekzemplar/mostër;
- g) të dhëna të tjera (si numri i telefonit, adresë postare, adresë të postës elektronike etj.) të personit të kontaktit pranë subjektit.

3. Kërkesa sipas pikës 2, të këtij neni, duhet të jetë e nënshkruar nga personi fizik ose autoriteti më i lartë ekzekutiv i personit juridik dhe të jetë e vulosur me vulën përkatëse të subjektit.

4. Në rastin kur Banka e Shqipërisë vlerëson se kërkesa e subjektit është e plotë, si dhe krijon bindjen për sa përcaktohet në pikën 1 të këtij neni, lëshon autorizimin përkatës. Autorizimi nënshkruhet nga drejtori i Departamentit të Emisionit, bazuar në relacionin e përgatitur nga Qendra Kombëtare e Analizës, pranë Departamentit të Emisionit në Bankën e Shqipërisë.

5. Në rastet e riprodhimit të kartëmonedhave euro, që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 5 të kësaj rregulloreje, Banka e Shqipërisë mund të lejojë përdorimin e këtyre riprodhimeve

në Republikën e Shqipërisë, nëse subjekti paraqet një kopje të noterizuar të autorizimit të lëshuar nga Banka Qendrore Evropiane ose nga një prej bankave qendrore të Eurosistemit për lejimin e riprodhimit përkatës.

Neni 8

Zbatimi i kërkesave rregullative

1. Subjektet marrin masat e nevojshme për zbatimin e kërkesave të kësaj rregulloreje jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e saj.

2. Në rastet kur Banka e Shqipërisë konstaton ose vihet në dijeni/informohet për mosrespektimin e kërkesave të kësaj rregulloreje, u kërkon subjekteve të marrin masa korrigjuese brenda një afati kohor të caktuar.

3. Në rast moszbatimi të masave korrigjuese nga subjekti, brenda afatit të kërkuar, Banka referon rastin pranë organeve përkatëse ligjzbatuese.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore do të hyjë në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETAR I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Gent Sejko

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 64 lekë